



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

Date. 18.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

“Blerje detergjent dhe materiale pastrimi”.
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje detergjent dhe materiale pastrimi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39831200-8, 39830000-

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 463 510 (një milion e katërqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqindë e dhjetë) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Formulari i Sigurimit të Ofertes sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1/a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht **585 404 (pesëqindë e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqindë e katër)** lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës;

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:

2.3.1/a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (vlera e pritshme e kontratave) ose **292 702 (dyqindë e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqindë e dy)** lekë pa tvsh.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të

realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2/b. Operatori ekonomik duhet të jetë I certifikuar sipas standarteve ISO 9001-2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 9001: 2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë: Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

2.3.3/c. Ofertuesi nepermjet nje deklarate duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin e mallrave prane AK.

Argumentimi: nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriter i cili vleresohet i nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

SPECIFIKIME TEKNIKE
PËR DETERGJENTE DHE MATERIALE PASTRIMI

Nr	Pershkrimi I materialeve	Njesia	Sasia
1	Detergjent për pllaka	litër	5500
2	ACE detergjent ose ekuivalent	litër	300
3	Acid per pllaka	litër	5500
4	Klor	litër	6000
5	Detergjent lares duarsh	litër	20
6	Leter higjenike (10 rrula)	pako	15
7	Shkopa	copë	700

8	Doreza	palë	500
9	Fshesa pastrimi me bisht	copë	600
10	Shtupe pastrimi pllakash	copë	600
11	Qese mbeturinash, madhesia 90*60	pako	450
12	Furce pastrimi Wc + mbajtese	komplet	80
13	Mbledhese mbeturinash	copë	100
14	Pastrues universal per soba,pianura	litër	80

- 1. Detergjent pllakash** - Pastrues aromatik i përdorimit të përgjithshëm, me aromë.I përshtatshëm për vende higjienike, koridore dhe tualete, paketim me bidon plastik 1-5 litër
- 2. ACE detergjent ose ekuivalent** - Detergjent higjienizues me baze klori aktiv, e cila higjienizon rrobat dhe sipërfaqet e ndryshme, duke eliminuar mikrobet dhe bakteret,. Detergjent me efekt zbardhues. Ambalazhim me bidon plastik 1 - 2.5 liter. Përdoret për larjen e rrobave të bardha
- 3. Acid per pllaka** - Acid për pastrim, të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike 1-5 litër
- 4. Klor** - Solucion i lëngshëm për larje të thellë. Bazë klori dhe të fortë për larjen e porcelaneve dhe pllakave. Paketim me bidon plastik 1 - 5 liter.
- 5. Detergjent lares duarsh** - Solucion për larje duarsh, (paketim 5 litër)- të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Detergjent kremoz jo irritues
- 6. Letër higjienike** - Letra higjienike 15 pako (paketimi 10 copë për pako), Të jetë cilësore dhe e tretshme në ujë
- 7. Shkopa** - Shkopa metalik jo me të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë metalik me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.
- 8. Doreza** - Doreza plastike që përdoren për larjen e tualeteve, masa S, M dhe L.
- 9. Fshesa pastrimi me bisht** - Fshesa me fije plastike, shume rezistente, per ambiente te brendshme
- 10. Shtupe pastrimi pllakash** - Shtupë për larje dysHEMEJE, e përbërë nga fibra tekstili që thithin ujin shumë mirë. Të ketë kokë plastike të filetuar për tu kapur në bisht.
- 11. Qese mbeturinash, madhesia 90*60** - Qese plastike te zeza per kosha te medhenj, rezistente, permasat 90x60 cm, pako me 10 cope qese.
- 12. Furce pastrimi Ęc + mbajtese** - Furce banjo me mbajtese me fije plastike per pastrimin e WC
- 13. Mbledhese mbeturinash** - Kaci për mbledhje mbeturinash. Materiali plastik dhe praktike në përdorim
- 14. Pastrues universal per soba, pianura** - Pastrues per pianura me ambalazh 750 ml, te largoj me lehtësi mbetjet vajore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Studentore është të kujdeset për mirëmbajtjen dhe pastrimin e godinave të RSU Nr.1. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi i mirëmbajtjes ka nevojë për pajisjen me detergjentet e domosdoshme dhe materialet e pastrimit. Detergjentet dhe materialet e pastrimit duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **30.07.2024, ora 12:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje detergjent dhe materiale pastrimi”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Njesia e prokurimit